



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E Martë, 2 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 798, datë 19.11.2014	Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Evropiane për Kërkime Bërthamore (CERN), në lidhje me bashkëpunimin teknik dhe shkencor në fizikën e energjisë së lartë	9391
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 799, datë 19.11.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....	9393
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, nr. 17, datë 19.11.2014	Për shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, thirrja e pestë.....	9393
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, nr. 20, datë 19.11.2014	Për shpërndarjen e fondit për projektet në vazhdim, për ujësjellës - kanalizime, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, si dhe ndryshime në vendimin nr. 10, datë 9.7.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për art-kulturë, pyllëzim dhe gjelbërim, si dhe ujësjellës - kanalizime, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve”.....	9395
	Vendim (i shkurtuar) për vërtetimin e faktit juridik të lindjes dhe të vdekjes së shtetasve Kahreman Vrioni (Saliaj) dhe Meleke Vrioni (Saliaj)	9398



VENDIM

Nr. 798, datë 19.11.2014

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
ORGANIZATËS EVROPIANE PËR
KËRKIME BËRTHAMORE (CERN), NË
LIDHJE ME BASHKËPUNIMIN TEKNIK
DHE SHKENCOR NË FIZIKËN E
ENERGJISË SË LARTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Evropiane për Kërkime Bërthamore (CERN), në lidhje me bashkëpunimin teknik dhe shkencor në fizikën e energjisë së lartë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
ORGANIZATËS EVROPIANE PËR
KËRKIME BËRTHAMORE (CERN) NË
LIDHJE ME BASHKËPUNIMIN TEKNIK
DHE SHKENCOR NË FIZIKËN E
ENERGJISË SË LARTË**

2014

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (Shqipëria), përfaqësuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, Lindita Nikolla, nga njëra palë, dhe Organizata Evropiane për Kërkime Bërthamore (CERN), organizatë ndërqeveritare me selinë e saj në Gjenevë, Zvicër, përfaqësuar nga drejtori i Përgjithshëm i saj, Rolf Dieter Heuer, nga pala tjetër, të referuara më poshtë si "Palët",

Duke marrë parasysh:

Se kërkimi në fizikën e energjisë së lartë synon zhvillimin e mëtejshëm të shkencës themelore dhe ecurisë teknologjike;

Se qëllimi i CERN-it është të forcojë bashkëpunimin me shtetet që nuk janë anëtare të CERN-it, por me të cilët ka vendosur bashkëpunimin;

Interesin e Shqipërisë për pjesëmarrje në programin shkencor të CERN-it;

Kontaktet e krijuara midis CERN-it dhe Shqipërisë;

Vullnetin e palëve për krijimin e kuadrit për të siguruar për një periudhë afatgjatë, mundësinë e pjesëmarrjes nga shkencëtarët, inxhinierë dhe teknikë nga Shqipëria, në projektet kërkimore të CERN-it dhe për parashikimin e kontributeve të tjera të këtij lloji, siç mund të bien dakord palët;

Përfitim të përbashkët, nga ku palët presin rezultat nga bashkëpunimi i tyre,

bien dakord si më poshtë.

Neni 1

Fusha e veprimit

Kjo marrëveshje bashkëpunimi (Marrëveshja) përbën kuadrin, brenda së cilës palët, bazuar në bashkëpunimin e përbashkët, do të zhvillojnë më tej bashkëpunimin e tyre teknik dhe shkencor.

Neni 2

Qëllime joushtarake

Palët do të përdoren rezultatet e bashkëpunimit të tyre për qëllime joushtarake.

Neni 3

Format e bashkëpunimit

Qëllimi i nenit 5 të kësaj marrëveshjeje, Shqipëria do të mbështesë projekte të tilla kërkimore të CERN-it për të cilat institutet e kërkimit shkencor dhe institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri kanë ekspertizë të veçantë, duke përfshirë fushën e fizikës eksperimentale dhe teorike, përshtetuese, të inxhinierisë elektronike dhe të informatikës. Përkrahja mund të jetë në formën e burimeve njerëzore, njohurive (*know-how*), pajisjeve, materialeve, fondeve apo ndonjë kombinim i tyre.



Neni 4

Mbështetja në burime njerëzor

4.1 Kur mbështetja është në formën e burimeve njerëzore, CERN-i merr parasysh kërkesat nga shkencëtarë, inxhinierë dhe teknikë nga Shqipëria për zgjedhjen dhe emërimin e tyre si anëtarë të personelit të CERN-it. CERN-i rast pas rasti mund të vendosë të ofrojë kontribute në përballimin e kostove të tyre për shpenzimet e jetesës në rajonin e CERN-it.

4.2 Shkencëtarë, inxhinierë dhe studentë nga Shqipëria që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes mund të kandidojnë për të marrë pjesë në shkollat e CERN-it, duke përfshirë Shkollën e Shkencave Teknologjike, Shkollën e Shkencave Kompjuterike, Shkollën Evropiane të Fizikës dhe Shkollën Verore të Programit të Studentëve në CERN.

4.3 CERN-i do të trajtojë të gjithë aplikimet në përputhje me meritat e tyre.

Neni 5

Zbatimi

5.1 Zbatimi i kësaj marrëveshjeje është subjekt i nënshkrimit të protokolleve ndërmjet CERN-it dhe Shqipërisë dhe/apo instituteve të kërkimit shkencor dhe institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri, dukje detajuar për çdo projekt kërkimor bashkëpunimin ndërmjet palëve që nënshkruajnë protokollin, në lidhje me objektivat, programin, burimet, statusin e stafit, pronësisë intelektuale, përgjegjësinë dhe çështje të tjera. Çdo protokoll mund të plotësohet nga shtojca të detajuara.

5.2 Protokollat do të përcaktojnë se kushtet e kësaj marrëveshjeje do të jenë të zbatueshme me ndryshime të nevojshme midis palëve të këtyre protokolleve.

Neni 6

Protokollin mbi privilegjet dhe imunitetet e CERN-it

Me qëllim lehtësimin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, Këshilli i Ministrave, me anë të kanaleve të njohura, do të promovojë nënshkrimin nga ana e Shqipërisë të protokollit mbi privilegjet dhe imunitetet e Organizatës Evropiane për Kërkime Bërthamore, miratuar nga Këshilli i CERN-it më 19 dhjetor 2003.

Neni 7

Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje midis palëve, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje, zgjidhet në përputhje me procedurën e përcaktuar në shtojcën e kësaj marrëveshjeje.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

8.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët. Kur kjo marrëveshje miratohet apo ratifikohet më vonë, ajo hyn në fuqi në datën në të cilën pala e interesuar njofton me shkrim palën tjetër mbi vendimin e miratimit apo të ratifikimit.

8.2 Kjo marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë fillestare prej pesë vjetësh dhe rinovohet automatikisht, çdo herë për një periudhë të re pesëvjeçare, përveç rastit kur njëra prej palëve njofton me shkrim të paktën gjashtë muaj para datës së rinovimit palën tjetër për ndërprerjen, ose ripërtëritjen e saj për një periudhë tjetër.

Kjo marrëveshje nënshkrimet e hartuar në dy kopje, në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në rast paqartësisht ose kundërshtish, palët i referohen marrëveshjes në gjuhën angleze.

SHTOJCË

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me konsultim ndërmjet palëve

Në rast mosmarrëveshjesh që nuk zgjidhen me anë të konsultimeve, përjashtuar rastet kur palët bien dakord me një mënyrë alternative zgjidhjeje, pala e interesuar paraqet ankimum pranë gjykatës së arbitrazhit, e cila duhet të përbëhet nga tre anëtarët, përkatësisht një anëtar i zgjedhur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, një anëtar i zgjedhur nga drejtori i Përgjithshëm i CERN-it apo personi që vepron në vend të tij ose të saj, dhe një anëtar i zgjedhur bashkërisht nga dy anëtarët e tjerë, i cili nuk duhet të jetë as përfaqësues i CERN-it, apo as i Shqipërisë. Ky anëtar është kryetar i Gjykatës së Arbitrazhit.

Ankimimi duhet të përmbajë emrin e anëtarit të zgjedhur nga ankimesi. I padituri cakton anëtarin e dytë dhe informon palën tjetër mbi emrin e kësaj të fundit, brenda dy muajve nga njoftimi. Në rast të kundërt ose në rastin kur dy anëtarët e përzgjedhur



nga palët nuk bien dakord për zgjedhjen e anëtarit të tretë brenda dy muajsh pas emërimit të anëtarit të dytë, anëtari i tretë zgjidhet nga kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, me kërkesë të ankimuesit.

Gjykata vendos rregullat e saj mbi procedurën. Vendimet e saj janë detyruese për palët pa të drejtë ankimi.

VENDIM

Nr. 799, datë 19.11.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “D”, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohet individ i renditur në shkronjën “a” të listës, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas ndryshimeve në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat, që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTA E OKB-së) LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”;

1.AL-HARAMAIN FOUNDATION (UNITED STATES OF AMERICA)

Shënim. Gjeneralitet e tjera për personat, emrat e të cilave janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM

Nr. 17, datë 19.11.2014

PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE, THIRRJA E PESTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte të infrastrukturës vendore, në vlerën 37 656 471 (tridhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë zhvillimore, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 2, të këtij vendimi, brenda një jave pas publikimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin pranë sekretariatit teknik për infrastrukturën vendore, në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, një kalendar me të gjitha afatet e prokurimit publik dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve (realizimit të investimit), për të vlerësuar realizimin e investimeve.



3. Të gjitha autoritetet kontraktuese (njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë zhvillimore), projektet e të cilave miratohen për t'u financiar, sipas pikës 2, të këtij vendimi, deri në fillim të tremujorit të dytë të vitit 2015, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të rishqyrtuar financimin dhe rialokimin e fondeve të këtij financimi për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit të kryejë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Njesisë së Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje në pikën 3, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe

Ndhmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Anëtar
Ministri i Financave	Anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Anëtar
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar
Ministri i Kulturës	Anëtar
Ministri i Mjedisit	Anëtar
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar

Tabela 1. Projektet për financim të infrastrukturës vendore, thirrja e pestë

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit në lekë	Vlera e financimit, 2014 në lekë
Qarku Berat				
1	Bashkia Berat	Rikonstruksioni i Trotuarëve, parmacëve dhe ndricimit, në segmentin Ura e Varur-Ura e Goricës, Berat	59,199,026	5,919,903
2	Bashkia Berat	Rikonstruksioni dhe rikualifikimi urban I lulishtes perëndimore (Loti Opsional) dhe suplementi i Sheshit Qendror "Teodor Muzaka" (Loti 3 pjesor), Berat	59,918,933	5,991,893
3	Bashkia Berat	Ndërtimi i Kullës së Sahatit, Berat	4,997,900	499,790
4	Bashkia Ura Vajgurore	Rehabilitimi, ndricim, gjelbërim i shëtitores së Lagjes 18 Tetori , Ura Vajgurore	61,290,278	6,129,027
5	Bashkia Ura Vajgurore	Ndërtimi i kompleksit sportiv të lagjes 18 Tetori, Ura Vajgurore	20,678,343	2,067,834
Qarku Vlorë				
3	Bashkia Vlorë	Sistemim asfaltim Rruga nga Muzeu Historik - Spitali Vlorë, loti 1 (Rruga "Perlat Rexhepi" dhe "Ali Demi")	59,993,389	5,999,339
4	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës hyrëse të fshatit Dardhë	67,277,554	6,750,757
Qarku Tiranë				
5	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitimi i gjelbërimit anësor i rrugës IKV-Surrel	42,979,282	4,297,928
TOTALI			376,334,705	37,656,471



- Shënim: 1. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të).
 2. “Vlera e financimit për vitin 2014” tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.
 3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014 do të financohet nga FZHR-ja për vitin 2015.
 4. “Objektet me autoritet kontraktues bashkinë Berat, (projektet 1, 2 dhe 3) do të zbatohen në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”.

VENDIM

Nr. 20, datë 19.11.2014

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR
 PROJEKTET NË VAZHDIM, PËR
 UJËSJELLËS - KANALIZIME, PJESË E
 FONDIT PËR ZHVILLIMIN E
 RAJONEVE, SI DHE NDRYSHIME NË
 VENDIMIN NR. 10, DATË 9.7.2014, TË
 KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E
 RAJONEVE, “PËR SHPËRNDARJEN E
 FONDIT PËR ART-KULTURË,
 PYLLËZIM DHE GJELBËRIM, SI DHE
 UJËSJELLËS - KANALIZIME, PJESË E
 FONDIT PËR ZHVILLIMIN E
 RAJONEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për financimin e mbetur, të papërdorur, për projektet në vazhdim (të miratuara me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve gjatë viteve 2012-2013), në fushën e ujësjellës - kanalizimeve, në vlerën 424 119 369 (katërqind e njëzet e katër milionë e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në listën nr. 1, që i bashkëlidhej vendimit nr. 10, datë 9.7.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për art - kulturë, pyllëzim dhe gjelbërim, si dhe ujësjellës - kanalizime, pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve”, bëhen ndryshime sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi. Diferenca e financimit të mbetur, pas ndryshimeve sipas pikës 2, të këtij vendimi, përdoret nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për të financuar

projekte dhe programe të tjera.

3. Të gjitha autoritetet kontraktuese, me projekte të financuara sipas pikave të përmendura më sipër, duhet të paraqesin pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, brenda 2 (dy) javësh nga publikimi i këtij vendimi, një kalendar me të gjitha afatet e përfundimit të punimeve të ndërtimit dhe përdorimit të fondeve (realizimit të investimit). Gjithashtu, autoritetet kontraktuese duhet të paraqesin rregullisht, pranë sekretariatit teknik, informacion për ecurinë financiare të disbursimeve të projekteve, të shoqëruar me dokumentet përkatëse.

4. Ngarkohet sekretariati teknik pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, të kryejë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Njesisë së Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, sipas dokumenteve të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, sipas pikës 3, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
 Edi Rama**

Zëvendëskryeministri	Anëtar
Ministri i Financave	Anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Anëtar
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar
Ministri i Kulturës	Anëtar
Ministri i Mjedisit	Anëtar



Ministri i Punëve të Brendshme

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore

Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë

Kryetari i Shoqatës së Komunave

të Shqipërisë

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë

Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore

Anëtar

Anëtar

Tabela 1. Lista e projekteve të Ujësllës-Kanalizimeve, të miratuara me vendim të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, në 2012-2013, për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Vlera e kontratës	Financimi total deri në nëntor 2014	Financimi i planifikuar për 2014
QARKU BERAT					
1	Komuna Lumas	Ndërtim KUZ në fshatin Pullumbas	31,513,000	19,321,000	12,192,000
2	Komuna Sinjë	Ujësllësi Paftal - Galine	22,279,000	21,799,000	480,000
3	Komuna Perondi	Ndërtim KUZ i fshatit Magjate	41,077,000	25,435,000	7,289,000
4	Komuna Perondi	Ujësllësi Rreth Tapi	21,289,000	13,170,000	327,000
5	Komuna Vendresh	KUZ fshati Therepel	15,284,000	10,019,000	5,265,000
6	Komuna Çepan	Ujësllësi i fshatit Prishtë	17,146,000	17,040,000	106,000
QARKU DIBËR					
7	Komuna Lis, Mat	Ujësllësi i fshatit Shoshaj	33,498,000	20,632,000	12,866,000
8	Komuna Koms	Ujësllësi i fshatit Germen (Rrjeti i shpërndarës i fshatit Muxhakë)	46,594,000	26,928,000	15,689,000
9	Komuna Macukull	Rikonstruksion i kaptazheve të ujësllësit të fshatit Macukull	8,391,000	8,221,000	170,000
10	Komuna Shupenze	Furnizimi me ujë i disa fshatrave të komunës Shupenzë	75,845,000	44,296,000	31,549,000
QARKU DURRËS					
11	Komuna Gjepalaj	Ndërtimi i KUZ fshati Hardhishte, Lagja e Greceve	26,987,000	16,836,000	10,151,000
12	Sh.A.Uj. Durrës	"Furnizimi me ujë të pijshëm i fshatit Shënavlash (Linja Autostradë - fshati Shënavlash)	20,663,000	10,532,000	180,000
13	Sh.A.Uj. Durrës	Sistemi i ujërave të ndotura lagje nr. 14, Shkozë	19,383,000	13,613,000	402,000
14	Sh.A.Uj. Durrës	Shttrim linje të re ujësllësi Rashbull, zona pranë shkollës Shkallnur	18,607,000	13,306,000	5,301,000
15	Sh.A.Uj. Durrës	Përmirësimi i furnizimit me ujë, zona Spitalë Porto - Romano	38,346,000	14,775,000	4,830,000
QARKU ELBASAN					
16	Bashkia Belsh	Ujësllësi i fshatit Trojas-Zekth (linja e dërgimit, shpërndarjes dhe depo b/a 100 m ³)	12,179,000	11,855,000	324,000
17	Komuna Klos	Rikonstruksion ujësllësi i fshatit Banje e Re - Trunc	8,349,000	8,195,000	154,000
18	Komuna Polis	Ndërtim i ujësllësit të fshatit Mirakë, lagje Gjovac	3,270,000	3,018,000	252,000
19	Bashkia Përrenjas	Ujësllësi i fshatit Rashtan	21,345,000	7,813,000	1,065,000
QARKU FIER					
20	Komuna Strum	Furnizimi me ujë i fshatrave Suke 1 dhe Arapaj	48,870,000	30,137,000	18,733,000
21	Bashkia Roskovec	Furnizimi me ujë i qytetit të Roskovecit	37,910,000	28,603,000	9,307,000
22	Komuna Qendër Mallakastër	Ndërtimi i ujësllësit për furnizimin e fshatrave Lapupec, Lofkend nga depo e Kashit dhe linja e shpërndarjes për Lapulec.	79,845,000	43,863,000	29,145,259
23	Komuna Strum	KUZ fshati Velmish	64,686,000	23,664,000	41,022,000



24	Komuna Kolonje	Ujësjetllësi i fshatit Kolonjë	76,208,000	43,013,000	26,726,960
		QARKU GJIROKASTËR			
25	Komuna Picar	Ujësjetllësi i fshatit Kolonjë	12,950,000	10,344,000	156,000
26	Komuna Petran	Rikonstruksion ujësjetllësi Qilarisht	22,617,000	13,124,000	7,594,400
27	Komuna Ballaban	Rikonstruksion i ujësjetllësit I fshatit Pavar	11,046,000	10,747,000	299,000
28	Komuna Lopës	Kanalizime të ujërave të zeza Dhemblan	13,991,000	10,174,000	3,817,000
		QARKU KORÇË			
29	Komuna Libonik	Projektim pus shpimi për furnizimin me ujë të fshatit Symizë	2,415,000	2,305,000	110,000
30	Komuna Trebinje	Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjetllësit të fshatit Kalivaç	7,105,000	6,919,000	186,000
31	Komuna Hocisht	Ujësjetllësi i fshatit Baban	24,355,000	15,885,000	8,470,000
32	Komuna Hocisht	Rrjeti i jashtëm i ujësjetllësit Verlen	22,779,000	13,304,000	7,674,750
		QARKU KUKËS			
33	Komuna Surroj	Ujësjetllës për lagje Ali Vataj	8,466,000	8,318,000	148,000
34	Komuna Fajzë	Ndërtimi Ujësjetllësit i Toblit (Metaliaj) dhe Treganit (Kapicë, Branog)	55,715,000	29,471,000	2,231,000
35	Komuna Golaj	KUZ fshati Letaj (lagjet Qunaj, Bardhosh - Kamber)	7,511,000	2,629,000	4,882,000
36	Komuna Fierze	Ujësjetllësi fshatit Kokez- Dushaj	19,949,000	15,777,000	4,172,000
		QARKU LEZHË			
37	Komuna Milot	Rikonstruksion i ujësjetllësit të qytetit Milot	88,562,000	31,419,000	57,143,000
		QARKU SHKODËR			
38	Sh.A. Ujësjetlles Fshat	Ujësjetllësi në fshatin Kullaj-Rrethina faza e III	80,322,000	68,872,000	11,450,000
39	Komuna Bushat	Ndërtim rrjeti KUZ për fshatrat Bushat 2, Rranxa 2, Fshati i ri 2, Barbullush 2. Faza e I	85,747,000	63,139,000	22,608,000
40	Komuna Qafe Mali	Rikonstruksion ujësjetllësi Kryezi (faza II)	7,037,000	6,879,000	158,000
41	Komuna Qafe Mali	Rikonstruksion i ujësjetllësit ekzistues, fshati Paluce	5,943,000	5,764,000	179,000
42	Komuna Gruemire	Ndërtim ujësjetllësi Gjorm i Poshtëm	7,300,000	6,378,000	922,000
		QARKU TIRANË			
43	Komuna Kashar	Ndërtim ujësjetllësi fshati Yrshek	51,790,000	28,363,000	23,427,000
44	Komuna Zall-Bastar	Rikonstruksion i ujësjetllësit qendër Zall-Bastar	21,511,000	13,931,000	7,580,000
45	Komuna Kërrabë	Ndërtim ujësjetllësi Mushqeta	11,559,000	11,343,000	216,000
46	Komuna Petrelë	Kanalizimi i ujërave të zeza, Petrelë	17,351,000	13,696,000	3,655,000
47	Komuna Kërrabë	Ujësjetllësi I fshatit Skuterre	15,119,000	14,447,000	672,000
		QARKU VLORË			
48	Komuna Shushicë	KUZ i fshatrave Llakatund dhe Shushicë	39,265,000	20,862,000	18,403,000
49	Bashkia Selenicë	Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjetllësit qytetit Selenicë.	84,055,000	70,305,000	1,190,000
50	Komuna Vergo	Ndërtim ujësjetllësi i fshatit Fushë - Verri	17,859,000	14,609,000	3,250,000
		TOTALI	1,531,883,000	985,088,000	424,119,369



Shënim 1: "Vlera e financimit për vitin 2014" tregon vlerën e paraqitur nga sekretariati teknik përkatës, në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, për shlyerjen e detyrimeve për projektet në vazhdim, të miratuara me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, 2012-2013. Kjo vlerë përfaqëson diferencën midis vlerës së kontratës dhe vlerës së paguar të financimit deri më tani.

2. Financimi i projekteve bëhet sipas vlerës totale të kontratës së lidhur, duke respektuar detyrimin e palës kontraktuese për likuidimin e vlerës së garancisë financiare për realizimin e punimeve, mbajtur në situacionin përfundimtar.

Tabela 2. Lista e projekteve të Ujësjiellës-Kanalizimeve me reduktim financimi për vitin 2014

Nr	Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Vlera e kontratës me TVSH	Financimi i planifikuar për 2014	Vlera e mundshme për disbursim për vitin 2014
Qarku Vlorë					
1	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i brendshëm i ujësjiellësit në lagjen 4, "Baba Rexhepi", dhe Lugu i Dardhës	148,532,343	112,000,000	22,279,851
2	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtimi i ujësjiellësit Dhërmi	35,220,906	30,882,138	5,283,136
3	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtimi i ujësjiellësit Fresco, Dhërmi	20,477,677	22,610,000	3,071,652
4	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtimi i ujësjiellësit Ksamil (vazhdim)	17,118,612	24,513,225	2,567,792
5	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Projekti i ujësjiellësit të fshatit Manastir (vazhdim)	14,240,132	16,320,137	2,136,020
TOTALI			235,589,670	206,325,500	35,338,451

Shënim 1. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga FZHR.

2. "Vlera e financimit" për vitin 2014 tregon vlerën e financimit që u vu në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas vendimit 10, datë 9.07.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, "Për shpërndarjen e fondit për art-kulturë, pyllëzim dhe gjelbërim, si dhe ujësjiellës - kanalizime, pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve"

3. "Vlera e mundshme për disbursim" për vitin 2014, tregon vlerën faktike të disbursimit, që do të financohen, për vitin 2014, sipas ecuresë së punimeve

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, me vendimin nr. 150/22-2014-229, datë 24.10.2014, vendosi:

- Vërtetimin e faktit juridik se shtetasi Kahreman Vrioni (Saliaj) ka lindur në Berat, në vitin 1860 dhe duke mos pasur një datë të saktë, cakton si datë të lindjes së tij, datën 1 janar të vitit 1861.

- Vërtetimin e faktit juridik të vdekjes së shtetasit Kahreman Vrioni (Saliaj), në Psar, Përmet në vitin 1944 dhe duke mos pasur datë të saktë, cakton si datë të vdekjes së tij datën 1 janar të vitit 1945 për të gjitha pasojat ligjore.

- Vërtetimin e faktit juridik se shtetasja Meleke Vrioni (Saliaj) ka lindur në vitin 1870 dhe duke mos pasur datë të saktë lindjeje, cakton si datë të lindjes së saj, datën 1 janar të vitit 1871.

- Vërtetimin e faktit juridik të vdekjes së shtetasës Meleke Vrioni (Saliaj) në Psar, Përmet në vitin 1944 dhe duke mos pasur datë të saktë, cakton si datë të vdekjes së saj datën 1 janar të vitit 1945 për të gjitha pasojat ligjore.

- Me kërkesën e çdo të interesuari, gjykata mund të ndryshojë datën e vdekjes së secilit, kur vërtetohet se personi ka vdekur në një ditë tjetër.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 12 lekë